

VENDIM
Nr. 124, datë 19.6.2024

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 116, DATË 24.5.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ‘BLUE 1’, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.6.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 833/3 prot., datë 14.6.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw””, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.5.2022, të ndryshuar me vendimin nr. 65, datë 12.4.2024, ka vendosur të licencojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga dokumentimi në ERE i testimit/komisionimit të centralit, por jo më vonë se data 9.7.2026.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 65/2024, me shkresën nr. 833/2 prot., datë 16.4.2024.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/3 prot., datë 24.5.2024, shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka bërë me dije se më datë 23.5.2024, ka nënshkruar me shoqërinë “OST” sh.a. “Marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ‘Blue 1’”, marrëveshje e cila është nënshkruar pas kalimit të fazës së testeve 72-orëshe të monitoruara nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 715/4 prot., datë 30.5.2024, shoqëria ka depozituar dhe “Marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik ‘Blue 1’”, me nr. 2935 prot., datë 23.5.2024, lidhur ndërmjet “OST” sh.a. dhe shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. Pjesë e kësaj marrëveshjeje janë dhe testimet e centralit të kryera në praninë e përfaqësuesve të “OST” sh.a.

- Duke qenë se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka dokumentuar testimin dhe energjizimin e centralit fotovoltaik, propozojmë pranimin e kërkesës së saj dhe ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116/2022, të ndryshuar, duke e nisur fillimin e afatit 25-vjeçar të licencës së saj në datën 23.5.2024.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“1. Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 23.5.2024.”

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti